REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MIRDITË**

**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 637/3 Prot Rrëshen, më 26.03.2026

**VENDIM**

**Nr. 16 datë 19. 03. 2026**

**PËR**

**"PËRDORIM FOND REZERVË - DHËNIE NDIHMË FINANCIARE",**

**BASHKIA MIRDITË**

Në mbështetje të ligjin nr. 139/2015,"Për vetëqeverisjen vendore" *i ndryshuar*, ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", në ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligji nr. 87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026", në Udhëzimin nr. 9, datë 20.07.2018, "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Udhëzimin nr. 2, datë 14.01.2026, "Për miratimin e buxhetit 2026", VKB nr. 98, datë 10.12.2025, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026", *Kërkesën nr. 637 prot, datë 05.02.2026, relacionin nr. 637/1 prot, datë 16.02.2026, "Mbi vlerësimin ekonomik - social të familjes të Znj. Marie Gjin Paloka", nga sektori i Ndihmës Sociale të Bashkisë,* së bashku me projektin-vendimin e Kryetarit Bashkisë, *shqyrtimin e miratimin, në mbledhjen e datës 18.03.2026, të Komisionit Ekonomisë, Financës dhe Buxhetit,* për t'a kaluar në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, pas diskutimeve;

**VENDOSI:**

1. Të miratojë përdorimin e fondit rezervë, *në shumën* ***50 000*** *(pesëdhjetë mijë) lekë*, për dhënie ndihmë financiare, si vijon;

- T'i akordojë ndihmë financiare, Znj. Marie Gjin PALOKA me ID; G15704020D, njësia administrative Rrëshen, për sëmundje të rëndë bashkëshortit

   a. **Paksim:** Fondi rezervë; (A1133 00 2133001 01 V491AAA..604) në vlerën;..**50 000** lekë

   b. **Shtohet:** Pagesë; (AA133 00 2133001 01 V111AAA...606) në vlerën;..........**50 000** lekë

2. Pagesa të kalojë, në degën e Postës Mirditë, zyra Postare Rrëshen

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, (Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Tatim Taksave)

*Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015,"Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar!*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MIRDITË

**SEKRETAR** **KRYETAR**

**Gaspër TOPOLLAJ** **Aleksandër PICAKU**

ADRESA: SHESHI "ABAT DOCI", RRËSHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPERISE

**BASHKIA MIRDITË**

**KËSHILLI I BASHKISË MIRDITË**

Nr 637/1 prot Rreshen me 18 / 02 /2026

**Nr. 17 date. 18 02.2026**

"PËR PERDORIM FOND REZERVE "

Mbështetur në ligjit 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin Nr. 9936 date 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ne ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", 87/2025, "Per buxhetin e vitit 2026" "Udhëzimin Nr.9 datë 20.07.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", në udhëzimin nr.2, datë.14.01.2026, "Për zbatimin e buxhetit 2026", ,ne VKB nr.98 datë 10.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026", në kerkesen , nr.637 prot, datë.05.02.2026, te AASNS, "Kerkese per ndihme financiare", këshilli i bashkisë Mirditë pasi diskutoi rreth projektit të paraqitur nga Kryetari i bashkise;

**V E N D O S I:**

***I-Të perdorë nga fondi Rezerve shumën 50 000 lekë, për dhënie ndihmë financiare si më poshte;***

1.Të Të japë ndihmë financiare familjes së zj.Marie Gjin Paloka (G15704020D), banuese Rreshen , NJA Rreshen, për semundje te rendete bashkeshortit.

**a-Paksim**:fondi rezervë ( AI133 00 2133001 01 V491AAA..604) për shumën ***50 000 lekë***

***b-Shtohet*** (AA133 00 2133001 01 V111AAA......606) për shumën ***50 000 lekë***

.2. Pagesa te kaloje ne degen e Postes Mirdite, zyra Postare Rreshen .

***II-.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe tatim taksave.***

***III-.Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.***

**SEKRETARI**
**Gaspër TOPOLLAJ**

**KRYETARI**
**Aleksander PICAKU**

**Paraqiten projektin**

Dr./zhvill ek dhe tatim taksat:: V.Gjoka

Dr.Juridike, prok, protokoll: M.Topollaj

**KRYETARI**
**Albert MËLYSHI**

REPUBLIKA E SHQIPERISË - BASHKIA MIRDITË

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 222162223www.bashkiamirdite.gov.al

Financa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MIRDITË**

**AGJENCIA E ARSIMIT SPORTIT DHE NDIHMËS SOCIALE**

SEKTORI NDIHMËS SOCIALE

**Nr 637/1 prot** **Rrëshen, më 16 / 02 / 2026**

**Lënda:** Relacion

**Drejtorisë së Financës**

**Bashkia Mirditë**

Lidhur me kërkesën e ardhur në Bashkinë Mirditë më 05.02.2026, me Nr.637Prot, drejtuar nga zj. Marie Gjin Paloka, e lindur në Prosek – Mirditë, më 04.07.1961, me NID G15704020D, për mbështetje ekonomike për bashkëshortin e sëmurë, ju japim relacionin si më poshtë:

Z. Mark Zef Paloka, i lindur në Kthell Epër – Mirditë, më 17.01.1948, me NID E80117031O ndodhet në një gjendje të rëndë shëndetësore, në pamundësi për të lëvizur, pasi pothuajse një vit më parë ka pësuar një trompozë të shkallës së lartë, me diagnozë Insult cerebral ishmeik në territorin e arteries cerebrale anteriore (ACA) djathtas. Si pasoje e kësaj ngjarjeje akute cerebrovaskulare, pacienti paraqet paralizë të anës së majtë, mungesë të të folurit, çrregullime neurologjike dhe varësi të plotë funksionale për aktivitetet bazë të jetës së përditshme, për të cilat kujdeset bashkëshortja e tij, zj.Marie Zef Paloka.

Zotëria në fjalë ka nevojë të domosdoshme për fizioterapi të përditshme afatgjatë, mbikqyrje të vazhdueshme, terapinë të rregullt dhe kontroll të vazhdueshëm mjekësor.

Nga pikëpamja sociale, familja përballet me vështirësi ekonomike, pasi të ardhurat mujore janë të kufizuara dhe nuk mbulojnë kostot e larta të trajtimit me ilaçe, kujdesit ditor dhe fizioterapisë së nevojshme.

Në përfundim, rasti paraqitet në gjendje të rëndë shëndetësore, me paaftësi të theksuar funksionale dhe varësi të plotë, për këtë si Shërbim Social i Bashkisë Mirditë e vlerësojmë të nevojshme dhënien e një mbështetjeje financiare.

Konceptoi: Adela Gjikola

Miratoi: Drejtori Aurel Çupi

Përgjegjës i Sekt.Soc. Gjergj Përgjoni

Nr. 637 Prot
Dt. 05.02.26

Rrëshen më: 04/02/2026

KËRKESË

**Drejtuar: Kryetarit të Bashkisë Mirditë, Z. Albert Mëlyshi.**

**Për dijeni: Këshillit Bashkiak Mirditë.**

**Lënda: Kërkesa për Ndihmë Ekonomike & për shoqerues i të sëmurit Z. Mark Zef Paloka (bashkëshortit tim).**

Unë e nënshkruara Marie Gjin Paloka, e datëlindjes 04.07.1961, lindur në fshatin Prosek, Mirditë e banuese në qytetin e Rrëshenit, Mirditë, prej 30 vitesh, me **NID: G15704020D** paraqes kërkesën time si më poshtë vijon:

Më datë **26.03.2025**, bashkëshorti im Mark Zef Paloka pësoi trumpozë të shkallës së lartë, me diagnozë (*të cilën po iu bashkëngjis një kopje të Epikrizes nga Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë*). Nga kjo datë ai është i paralizuar dhe nuk leviz nga vendi. Ka nevojë jo vetëm për një shoqerues por edhe më shumë. Nevoja e tij përveç ilaçeve (*bashkëngjitur dokumenti përkatës*), ka nevojë çdo ditë për fizioterapi, ku në spitalin e qytetit të Rrëshenit dhe në kishë nuk ka fizioterapist që e ofrojnë këtë shërbim pa pagesë. Gjatë këtyrë muajve kam marrë një fizioterapist në Laç ku për këtë më ka dhënë ndihmë Kisha e Shna Ndoit, por për fizioterapinë ai ka nevojë çdo ditë. Prandaj ju drejtohem juve me shpresën se do të më ndihmoni për këtë rast, sepse unë kam një pension jo me shumë se 10.000 lekë (të reja) i cili nuk i mbulon dot as nevojat e mia për ilaçe.

Mbetëm me shpresën se kjo kërkesë e imja do të merret në konsideratë sa më shpejt nga ana juaj.

Duke ju falenderuar paraprakisht.

**Me respekt**

**Marie Gjin Paloka**

*Cel: +355(0)683343436*